

Sekretariati i KQZ-së – tregim i suksesshëm

“Të organizuara mirë, transferim i suksesshëm i përgjegjëseve themelore për organizimin e zgjedhjeve në institucionet e Kosovës, dhe mbajtja e tyre në atmosferë të qetë dhe miqësore”. Me këto fjalë, më 24 tetor 2004, përfaqësuesi i Kongresit të autoriteteve vendore dhe rajonale të Këshillit të Evropës në një deklaratë zyrtare përshëndeti aktorin kryesor në Sekretariatit e KQZ-së, në Zgjedhjet e Kuvendit të Kosovës të vitit 2004. Ngjashëm me këtë, delegacioni i Parlamentit të Evropës nënvizoi “se për këto zgjedhje është themeluar një organ menaxhues mjaft efikas, në gjendje të udhëheqë të gjitha operacionet në mënyrë të suksesshme, madje krahasuar edhe me vendet tjera në rajon ku çështjet ndër-etnike janë më pak të rëndësishme.”

Alexander Benz e Karin Marmsoer, OSBE

Organi i ri vendor për menaxhim të zgjedhjeve

Sekretariati i KQZ-së si krah operues i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve këtë vit vërtetë ishte përgjegjës për shumicën e operacioneve zgjedhore duke përfshirë koordinimin dhe planifikimin në terren, çertifikimin e 33 subjekteve politike të radhitura në fletëvotim si dhe akreditimin e 13.000 vëzhguesëve vendor dhe ndërkombëtar. Përveç kësaj, organi i ri vendor për menaxhim të zgjedhjeve ka drejtuar një fushatë të gjërë për informim publik, organizimin e prodhimit të të gjitha materialeve dhe fletëvotimeve dhe trajnimin e stafit të punësuar në ditën e zgjedhjeve në të gjitha 1600 vendvotimet në tërë Kosovën

OSBE-ja mbanë disa kompetenca

Prapëseprapë një numër i detyrave të ndieshme kanë mbetur në përgjegjësi të OSBE-së: në veçanti menaxhimi i listës së votuesëve,



Fletëvotimet të gatshme për numrim në zgjedhjet e 23 tetorit, qendra e votimit Ali Sokoli, Prishtinë
Foto: Hasan Sopa/OSBE

NË KËTË NUMËR

Pritjet e qytetarëve fq. 3

Agjenda e Kuvendit të Kosovës fq. 5

Qëllimet kryesore – siguria dhe kthimi fq. 8

Të drejtat e njeriut në Kosovë fq. 11



programi për votim jashtë Kosovës si dhe numrimi i votave dhe paraqitja e rezultateve. Sipas qasjes së përgjithshme të transferimit të kompetencave, do t'i kushtohet rëndësi dorëzimit të aktiviteteve të mbetura para zgjedhjeve komunale të parapara për vitin 2006.

Përveç kësaj, OSBE-ja ishte përgjegjëse për këshillim dhe mbikëqyrje të anëtarve të stafit të SKQZ-së, duke ndihmuar në këtë mënyrë operimin e përgjithshëm të zgjedhjeve.

Sfidat për KQZ-në

Aktivitetet në terren përfshijnë menaxhimin e përafërsisht 10.000 personave, dhe kjo dëshmon një sfidë të vërtetë për Sekre-

tariatit. Mirëpo, me mbështetje të OSBE-së dhe stafit të saj në terren, të gjitha përgatitjet dhe aktivitetet në ditën e zgjedhjeve kaluan qetë dhe në mënyrë të organizuar. Më 23 tetor, në mëngjesin e hershëm, fletëvotimet u shpërndanë në 566 qendra të votimit, procesi i votimit në vendvotime ishte mbajtur sipas procedurave të pranura ndërkombëtare dhe pas mbylljes së vendvotimeve, kutitë e votimeve u transportuan në depot komunale dhe më në fund në Qendrën për Numërim dhe Rezultate. Për të udhëhequr këto operacione të ndryshme, KQZ-ja është mbështetur në 30 Komisionet Komunale për Zgjedhje dhe 1.622 Komisione të Vendvoti-



Bernard Vrbanić

Zëvendës i zëdhënësit të Misionit të OSBE-së në Kosovë

Standardet të plotësohen nga ata që duan përgjegjësi

Disa nga ju që e keni përcjellur buletin e OSBE-së, Detajet, sigurisht që ju kujtohet se Standardet janë përmendur shpesh në botimet e mëparshme të këtij publikimi. Standardeve për Funkcionimin e Institucioneve Demokratike dhe të Drejtave Pronësore, për shembull, i'u është kushtuar vëmendje e posaçme në fillim të vitit, gjatë fushatës së përbashkët të Standardeve. Në atë kohë, ne u fokusuam në çështje të veçanta që i takojnë kësaj kategorie. Në botimin tonë të fundit, që doli vetëm pak para zgjedhjeve parlamentare të 23 tetorit, ne ju informuam për standardet të cilat është dashur t'i merrni në konsiderim seriozisht, para se të shkoni

në vendvotime për ta hedhur votën tuaj.

Ne i'u përkujtojmë edhe një herë se ky është Plani për Implementimin e Standardeve për Kosovën, i cili duhet të jetë i pari the kryesori në mendjen e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, ministrave dhe personelit të Institucioneve të reja të Përkohshme Vetqeverisë (IPVQ) dhe të popullit të Kosovës. Tani, fillon puna e vërtetë dhe të gjitha premtimet vëhen në sprovë. Fushata politike ngriti çështjen e pavarësisë, po kjo nuk është në kompetenca të IPVQ-ve. Ajo çka partitë politike duhet të bëjnë janë planet realiste që i prekin çështjet që ndikojnë më së shumti në popullin e Kosovës. Veprimet në lidhje me standardet ku IPVQ-të kanë kompetenca, janë premtime që mund të bëhen dhe mbahen.

Pa progres të dukshëm në fushën e Standardeve, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara nuk do, dhe nuk mundet t'i vë në tryezë diskutimet për statusin final të Kosovës. Ky territor dhe banorët e tij do të mund ta fajësojnë vetëm veten dhe udhëheqësit e tyre për zgjatjen e pasigurisë, izolimit dhe stagnimit ekonomik. Çdo dhunë e ngjashme me atë të marsit që buron nga ky qorrrokak do të ishte faji i atyre që duan përgjegjësinë ta shpini Kosovën përpara... por janë të paafat ta bëjnë këtë.

Të gjithë e kanë të njohur frazën, 'me pushtet vie edhe përgjegjësi' dhe kjo është ajo që e bënë koalicionin udhëheqës të angazhohet më tepër në politika dhe punën e tij. Koalicioni do të vështrohet për së afërmi, jo vetëm nga opozita (e cila ka premtuar

të punoj shumë për të mbajtur këtë qeveri "të sinqertë"), por edhe nga bashkësia ndërkombëtare dhe Evropa, pjesë e së cilës Kosova dëshiron të bëhet një ditë. Por mbi të gjitha, ajo duhet të mbahet e përgjegjshme ndaj opinionit.

Përfaqësuesi i Lartë i BE-së për Politikë të Jashtme, Javier Solana, shpesh ka përsëritur se "Standardet vijnë së pari", pastaj vijnë bisedimet për statusin. Në fund të nëntorit, z. Solana e tha mjaft qartë se vetëm vlerësimi pozitiv mbi zbatimin e standardeve mund të çojë drejt bisedimeve për të ardhmen – hapi tjetër nuk mund të bëhet pa përparim. Vetëm duke marrë seriozisht punët që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me standardet, posaçërisht ato prioritete që ndihmojnë ndërtimin e një Kosove të qëndrueshme shumetnike, udhëheqësia e IPVQ-ve do të marrë një lloj të përkrahjes ndërkombëtare.

Pra, ja ku është një marrëveshje shumë e mirë e punës për të bërë pasi që, siç e pat thënë Karn Ross (ish-koordinator i UNMIK-ut për standarde) para shkuarjes së tij këtë verë, asnjë nga standardet nuk janë plotësuar tërësisht. Ato nuk mund të plotësohen, siç e pamë me zgjedhjet në tetor, por tani përfaqësuesit e popullit duhet të tregojnë se ka përmirësim. Përsëri është plotësisht brenda fuqisë së tyre të sigurojnë ecjen përpara. Është përgjegjësi e tyre ndaj popullit, përgjegjësi të cilën ata kanë vendosur ta ngrisin lartë. Mesi i vitit 2005 po vie shpejt dhe çka do të ndodh atëherë do të jetë rezultat i suksesit apo dështimit të tyre.

vijon nga fq. 1

meve, të rekrutuara dhe trajnuara gjatë dy muajve të fundit para ditës së zgjedhjeve.

Rregullimi i pronësisë vendore

Është e rëndësishme që për herë të parë Komisionet e Vendvotimeve kishin përgjegjësinë e plotë për procesin zgjedhor në vendet e tyre përkatëse, pa u ndihmuar nga mbikëqyrësit ndërkombëtarë. Ngjashëm me bartjen e përgjegjësisë nga OSBE-ja në SKQZ, edhe kjo ishte në pajtueshmëri me qasjen e përgjithshme të zgjedhjeve të këtij viti, që do të thotë të rregullohet procesi i pronësisë vendore në nivelin qendror dhe komunal. Në të vërtetë, Administrata Komunale jo vetëm që ka ofruar personel për themelimin e Komisionit Komunal për Zgjedhje por ka ofruar edhe mbështetje në aspektin e logjistikës, depove dhe transportimit.

Sekretariati i KQZ-së, në nivelin qendror ka punuar ngusht me Ministrinë e Shërbimeve Publike, të Arsimit dhe Financave, veçanërisht lidhje me sigurimin e qasjes në ndarjen e mjeteve financiare si dhe mbështetjen me resurse njerëzore dhe materiale për ditën e zgjedhjeve. Bashkëpunimi në mes të Sekretariatit dhe Komunave në zgjedhjet e tetorit ka vendosur bazën për zgjedhje të ardhshme të qëndrueshme.

Pa dyshim, SKQZ-ja ishte në gjendje të bazohet në zgjedhjet demokratike, të lira, të drejta dhe gjithëpërfshirëse nga tri ciklet e para të zgjedhjeve dhe të vazhdojnë me pritjet e larta nga shoqëria e Kosovës si dhe bashkësia ndërkombëtare në lidhje me përmbushjet e tij. Mirëpo ende ka rrugë për të bërë, dhe sfidat duhet të adresohen me qëllim që për zgjedhjet e ardhshme të bëhen përgatitje të përkryera – me shpresë se zgjedhjet e ardhshme do të menaxhohen nga vendorët.



DETAJE

Gazetë e publikuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë

OSCE HQ, 38000 Prishtinë / Priština, Kosovo
Tel: +381 38 500 162, Fax: +381 38 500 188
E-mail: press.omik@osce.org
Web site: www.osce.org/kosovo

Botuesi:
Sven Lindholm

Kryeredaktor:
Nikola Gaon

Redaktorë:
Hasan Sopa, Armend Tahirsylaj (Detaje)
Slaviša Mladenović (Detalji)

Faqosja:
Shpend Kada

Bashkëpunorët:
Edita Buçaj, Franklin DeVrieze, Arben Hajredinaj,
Magdalena Hejzyk, Rexhep Krasniqi, Fatime Lepaja,
Antoanela Pavlova, Gëzim Rexha, Halide Sadiku,
Mevlyde Salihu, Ardiana Sejdiu, Mustafa Skenderi,
Vasilija Stanić, Bernard Vrbanić

osce
Mission in Kosovo

Shënim:

Pikëpamjet e paraqitura apo prezantimi i materialeve të botuara nuk shprehin politikën, opinionet apo qëndrimet e misionit të OSBE-së në Kosovë.

Pritjet e qytetarëve

Shumica e qytetarëve e kanë kuptuar se njerëzit që ata i kanë zgjedhur kanë përgjegjësi ndaj tyre dhe se ata duhet të punojnë në mënyrë që t'ua bëjnë jetesën më të lehtë dhe ardhmërinë më të ndritshme. Ata mendojnë se qeveria e dytë duhet të jetë qeveria më realiste dhe duan zgjidhje të problemeve të tyre të përditshme.

Mevlyde Salihi, OSBE

Më 23 tetor 2004, qytetarët e Kosovës ushtruan të drejtën e tyre themelore duke hedhur votën për të zgjedhë përfaqësuesit e tyre qëndror për të dytën here me radhë. Zgjedhjet janë kosideruar të lira, të drejta e demokratike dhe janë mbajtur në një atmosferë paqësore.

Institucioni vendor që udhëhoqi zgjedhjet, Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ), është lavdëruar për punën e bërë mirë. Duke qenë pjesë e standardeve të vendosura nga bashkësia ndërkombëtare, zgjedhjet e suksesshme janë një hap i madh në rrugën për plotësimin e standardeve, por edhe një shenjë e progresit në Kosovë.

Sidoqoftë, pjesa më e vështirë për përfaqësuesit e zgjedhur fillon tash. Puna e palodhur dhe zgjidhja e problemeve konkrete do t'ua ndryshojë ndjenjat shumë qytetarëve të Kosovës, të cilët nuk janë të kënaqur me punën e qeverisë së kaluar gjatë tre viteve të fundit dhe nuk janë aq entuziast për qeverinë e posa formuar.

“Ndiehem i ofenduar me përpjekjet e tyre për t'i rregulluar rrugët mu para zgjedhjeve, ata mundohen të na mashtrojnë, e deri tash nuk janë mërëzitur për këtë,” thotë Eli, nga Prishtina. “Nuk jam entuziast me premtimet e vjetra ose të reja, unë dua të besoj në to, por nuk mundem,” thotë ajo.

Shumica e qytetarëve e kanë kuptuar se njerëzit që ata i kanë zgjedhur kanë përgjegjësi ndaj tyre dhe se ata duhet të punojnë në mënyrë që t'ua bëjnë jetesën më të lehtë dhe ardhmërinë më të ndritshme. Ata mendojnë



Qendra e OSBE-së për numrimin e votive në Prishtinë. Foto: Chris Cycmanick/OSBE

se qeveria e dytë duhet të jetë qeveria më realiste dhe duan zgjidhje të problemeve të tyre të përditshme.

“Pres që qeveria e re të punojë më shumë në zgjidhjen e problemeve, t'a zvogëlojë numrin e të papunëve të punojë në përmirësimin e ekonomisë dhe të sigurojë më shumë ujë dhe rrymë,” tha Kujtim Bytyqi, student në Universitetin e Prishtinës.

Dua më shumë reforma në sistemin e shkolimit, kështu që pres nga qeveria të punojë më shumë në këtë drejtim,” tha Burim Ko-

kollari, student i shkencave politike, duke shtuar, “se qeveria gjithashtu duhet të fokusohet në krijimin e më shumë vendeve të punës dhe në zhvillimin e ekonomisë.”

Statusi i pazgjidhur i Kosovës është njëra ndër çështjet për të cilën qytetarët mendojnë të jetë pengesë në zgjidhjen e shumë çështjeve që e bëjnë të vështirë jetën e tyre.

“Qeveria duhet ta konsiderojë çështjen e statusit si prioritare, sepse ka një stagnim në zhvillimin e brendshëm dhe të jashtëm për shkak të kësaj çështje,” thotë Kujtim Bytyqi. “Po, qeveria duhet t'a konsiderojë zgjidhjen e statusit final të Kosovës si prioritet të vetin,” shton Burimi.

Por, për disa qytetarë, qeveria duhet pikë së pari, të përpiqet ta kuptojë esencën e problemeve. Muhamet Azemi thotë se, “qeveria duhet t'i kuptojë problemet e kësaj shoqërie dhe pastaj të përpiqet t'i zgjidhë ato,” duke shtuar se “ajo duhet të ofrojë shërbime më të mira qytetarëve të saj dhe t'i mbrojë interesat e tyre.” “Shpresoj se qeveria që po formohet do të punojë më shumë se ajo e mëparmja edhe në çështjet që janë me rëndësi jetike për qytetarët e Kosovës,” tha Blerta Gashi, qytetare e Prishtinës.

Qeveria e re do t'i ketë katër vite për ta dëshmuar vetveten. Qytetarët duket se janë të lodhur nga fjalët dhe duan rezultate konkrete. Pesë vite pas konfliktit dhe me qeverinë e dytë që tani është konsoliduar, të zgjedhurit duhet të dëshmojnë se i meritojnë votat që u dhanë qytetarët duke i zgjidhur çështjet që u përkasin atyre dhe janë në interes të të gjithë banorëve të Kosovës.



“Shumica e qytetarëve mendojnë se qeveria duhet pikë së pari, të përpiqet ta kuptojë esencën e problemeve.”

Foto: Hasan Sopa/OSBE

Platformat e programeve politike të Kosovës

Nikola Gaon, OSBE

Domethënia e platformës

Të kërkuar fjalën “platformë” në fjalor mund të gjejmë me këtë definicionin: “politikë e shpallur ose program i një partie politike” – Fjalori Amerikan i Oksfordit.

Këto politika dhe programe politike krijojnë një bazë, “pjesa më e ulët mbi të cilën mbështetet ndërtesa” – Fjalori i Oksfordit, mbi të cilën ndërtohet struktura e një partie politike, dhe mbi atë strukturë zakonisht vije superstruktura.

Pra, shkurtimisht, platforma politike është një pjesë thelbësore e një partie e cila shpjegon se çka paraqet ajo parti.

Platformat e partisë

Për të krijuar një parti me strukturë dhe program të saj, duhet patur një platformë. Duhet ndjekur një tërësi besimesh dhe orientimesh pragmatike. Veç kësaj, të kesh një platformë, është kusht paraprak ligjor për të formuar një parti.

Nëpërmes platformave partitë ua komunikojnë elektoratit veçoritë e tyre, dallimet në qasjet e tyre në çështjet politike, ekonomike dhe sociale. Me platformë partitë u tregojnë qytetarëve përbërjen e tyre, ose më mire të themi, për çka ata luftojnë.

Në Kosovë

Vlerësimi i shumë ekspertëve politik është se partitë politike në Kosovë kanë një platformë të ngjashme. Si është e mundur kjo, mund të

mendoni. Pra, kjo është kështu!

“Shumica e partive politike kryesore të Kosovës citojnë këto prioritete: pavarësinë për Kosovën, më tepër kompetenca nga UNMIK-u, zbatimi i stadardeve, dhe ndonjëherë, privatizimi”. Znj. Ardiana Gashi, zyrtare për regjistrimin e partive politike në OSBE thotë, “Sidoçoftë, të gjitha këto prioritete dhe angazhime janë të njohura. Programet e partive nuk përmbajnë plane të posaçme veprimi ose afate kohore”.

Tani dhe atëherë

Pra, nëse shumica e entiteteve politike kanë të njëjtin qëllim, për çka ata po argumentojnë, ku është dallimi, për çka votuesit votojnë?

“Unë i dëgjoja njerëzit se çka flisnin për liderët e partive të ndryshme, për personalitetet e tyre, dhe kjo është se si unë vendose kujt të i’a jap votën,” tha Arbeni, 23 vjeç, kamarier nga Prishtina.

Duket se është karizëm, një bindje e fortë e njohur, një kujtim për ditët e vështira kur liderët e “ri” të vjetër i dhan rezultatet e pritura. Kjo nuk është befasese; është një model në shumë vende me një të kaluar të ashpër dhe me një të tashme të tensionuar.

Parashtrahet pyetja – cila është rruga tutje? A do ta gjejnë partitë politike rrugën e tyre unike për ta shpjer Kosovën përpara, dhe për ta bërë atë një vend ma të mirë për qytetarët e saj?

Ekzistojnë disa tregues pozitiv. Një nga partitë e reja politike e ka caktuar një afat prej një viti për adaptimin e kushtetutës së re të Kosovës që duhet të jetë një bazë për tërë legjislaturën.

Ndonjë ndryshim?

Megjithatë, nuk mund të thuhet se nuk ka ndryshime në platformat e partive politike. Ekzistojnë disa ndryshime dhe ato kryesisht janë në mes të partive politike shqiptare dhe atyre serbe të Kosovës. Të parët brengosen më së shumti për pavarësinë, të dytët citojnë kthimin, sigurinë dhe decentralizimin si prioritet të tyre.

Ka shumë pak diskutime për brengat e jetës së përditëshme.

Vendet e punës dhe arsimit mund të presin!

Pra vendet e punës, arsimit, dhe shëndetësia ende mund të presin. Kjo mbase me supozimin se jeta ndalon dhe njerëzit prehen derisa çështjet politike diskutohen.

Kjo nuk do të thotë se çështjet si statusi i Kosovës dhe decentralizimi nuk janë të rëndësishme, por jeta vazhdon përderisa këto çështje diskutohen – prindërëve u duhen vendet e punës, fëmijëve u duhet arsimimi, të vjetërët kanë nevojë për pensione.

Tani t’i marrim platformat e partive politike dhe të shohim se prej nga do të vijnë të gjitha këto?!



Agjenda e Kuvendit të sapozgjedhur të Kosovës

Pas seancës inauguruese të Kuvendit të Kosovës mbajtur më 3 dhjetor 2004, sfidat e reja për Kuvendin gjatë mandatit të dytë të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) u bënë më të qarta. Zgjedhja e koalicionit qeverisës nën udhëheqjen e kryeministrit Ramush Haradinaj, duke llogaritur në përkrahjen e partive shumicë në Kuvend, duke qenë të ballafaquara me opozitën parlamentare, shënon një fazë të re në zhvillimin e procesit politik në Kosovë. Çka do të thotë kjo për Kuvendin e Kosovës dhe funksionin e tij gjatë viteve të ardhshme?

Franklin De Vrieze, OSBE

Së pari vijnë ligjet

Një ndër detyrat e para dhe më të mëdha të Kuvendit është aprovimi i legjislaturës, të tillë siç është propozuar nga Qeveria. Bazuar mbi konsultimet me deputetët e Kuvendit mund të arrihet në përfundim se kalimi i kësaj legjislature është i nevojshëm për tu siguruar se legjislacioni më i rëndësishëm i miratuar së pari.

Gjatë mandatit të parë të IPVQ-ve, Kuvendi siguroi të dhëna prej ekspertëve dhe shoqëris civile për procesin e legjislaturës me organizimin e debateve publike. Gjatë fjalimit të tij në Kuvend më 3 dhjetor, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), Soren Jessen-Petersen inkurajoi Kuvendin të vazhdojë të punojë në këtë mënyrë dhe të ndërtohet mbi traditën e dëshmuar.

Së dyti, është me rëndësi që ligjet e miratuar dhe të shpallura gjithashtu po zbatohen. Është detyrë e Kuvendit të kontrollojë qeverinë në përpjekjet e saj që të përparojë në zbatimin e ligjeve të adoptuara nga Kuvendi.

Por ky nuk është fundi. Një raport i fundit përgatitur nga Misioni i OSBE –së në Kosovë zbuloi të meta serioze, që kanë të bëjnë me mungesën e legjislacionit shtesë që nevojitet për zbatimin e ligjeve, mospërputhjet midis ligjeve të ndryshme, dhe pjesë të tjera të ligjeve të aplikuueshme ose problemeve në lidhje me përkthimin dhe nxjerrjen e akteve ligjore. Deputetët e Kuvendit nga grupe të ndryshme duan që ta vendosin këtë çështje në agjendën e Komisioneve funksionale, kur ato të themelohen.

Çështja e dytë një qeveri më përgjegjëse

Me këtë, kalojmë në detyrën e dytë kryesore të Kuvendit: që qeveria të jetë përgjegjëse. Jo vetëm në çështjen e legjislacionit dhe zbatimit të tij, por edhe në fushën e zhvillimit të politikës, çështje specifike brengosëse për regionet apo qytetet e Kosovës si dhe në marrëdhëniet e mira të praktikës qeverisëse dhe transparencës së organeve ekzekutive. Në të gjitha këto fusha, Kuvendi duhet të ushtrojë të drejtën e vet të 'lajthitjes ekzekutive'.

Gjatë mandatit të parë të IPVQ-ve, anëtarët e tri partive kryesore shqiptare të Kosovës



"Dinamika e re në Kuvendin e Kosovës inkurajon debate politike me të zgjeruara dhe votim mbi çështje të veçanta" Foto: Hasan Sopa/OSBE

mbajtën pozitat kyçe në Qeveri dhe Kuvend dhe kjo rezultoi më shumë në praktikë të dobët të funksionimit të kontrollit parlamentar. Tani mund të pritet që opozita parlamentare do të përdorë të gjitha instrumentet e parapara me Kornizën Kushtetuese dhe Rregulloren e Procedurës për të shtytuar punën e Qeverisë. Instrumentet përfshijnë pyetjet gojore dhe të shkruara për Ministra, krijimi i një komisioni hetimor, ndarja tabelore i shkresave dhe interpelancave.

Kjo dinamikë e re mund të nxjerrë debate politike më të zgjeruara dhe votim mbi çështje të veçanta. Në lidhje me këtë, sfida përpara është që të zhvillohet një kulturë e një qeverie përgjegjëse dhe e një opozite konstruktive.

Një qeveri përgjegjëse, mund të vlerësohet se, do të vazhdojë të punojë për të zhvilluar procese transparente dhe demokratike të vendimmarrjes dhe të fillojë punën për t'i kuptuar stanadardet. Gjithashtu, një qeveri është përgjegjëse edhe ndaj nevojave të popullatës në përmirësim të kushteve të tyre jetësore.

Nga një opozitë konstruktive mund të pritet mbikëqyrja e zbatimit të rregullave dhe procedurave dhe një politikë të qeverisjes së mirë nga ana e qeverisë. Një opozitë konstruktive vlerëson punën e qeverisë bazuar mbi meritat e saja dhe ofron alternativat e veta politike.

Buxheti në rend të tretë

Detyra e tretë e Qeverisë së re është shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit të konsoliduar të Kosovës. Ministri i ri i financave, Haki Shatri, ishte udhëheqës i Komisionit Buxhetor gjatë mandatit të kaluar të Kuvendit. Sfida të reja janë udhëhequr në drejtim të zhvillimit të proceseve transparente në shpërndarjen e sforcitit buxhetor dhe kontrollit të efektshëm të buxhetit të secilës organizatë, në tërësi, në mes tjerash, shqyrtimin e buxhetit gjysëm vejtör.

Pas kësaj çështja e statusit

Bisedimet për statusin e Kosovës pritet të fillojnë në mes të vitit 2005 dhe mund të supozohet se kjo do të absorbojë shumë energji të Kuvendit të Kosovës. Pasi që arritja e standardeve e ka përkrahjen e të gjitha forcave më të mëdha të Kosovës, gjithashtu edhe për statusin, Kosovës i duhet të ketë një ekip negociuese që do të përfshinte partitë e përfshira në Kuvend. Siç e krahasojnë disa analist formulën e ekipit negociues me procesin në negociatat e Marrëveshjes së Ohrit, përfshirja e qeverisë dhe opozitës në ekipin për statusin final të Kosovës do të sigurojë qëndrueshmërinë dhe zbatueshmërinë e vendosjes së statusit final.

Kuvendi i Kosovës

Mustafa Skenderi, OSBE



Pas rinumrimit të votave, që gjithësesi shpalosi transparencën e sistemit zgjedhor, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm për Kosovën, Soren Jessen Petersen bëri çertifikimin e rezultatit të zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës 2004, si dhe ndarjen e 120 vendeve në Kuvend.

Në bazë të Kornizës Kushtetuese të Kosovës,

100 vende u ndahen drejtpërdrejt partive politike në bazë të sistemit proporcional të përfaqësimit, ndërsa 20 vende, të ashtuquajtura vende "të lëna anash", u rezervohen komuniteteve pakicë, që gjithashtu ndahen në bazë të sistemit proporcional të përfaqësimit. Dhjetë nga 20 vende të ashtuquajtura "të lëna anash" u rezervohen serbëve të

kosovës, 4 komuniteteve romë, ashkali and egjiptas, 3 për komunitetin boshniak, 2 për ate turk, dhe 1 për komunitetin goran.

Grafika e mëposhtme tregon rezultatet e zgjedhjeve sipas përqindjes së votave të fituara dhe numrit të vendeve të rezervuara për secilin entitet politik.



Rrugët e Prishtinës

Fotot: Hasan Sopa/OSBE



1



2



3



4



5

Foto 1, 2.

Pllakata të partive politike ende qëndrojnë të varur nëpër mure, duke lënë prapa shumë probleme të pazgjidhura!

Foto 3.

Një shembull i mirë që duhet ndjekur.

Foto 4.

Kujdes gropën! Mungojnë shenjat e duhura treguese.

Foto 5.

Reparimi i rrugëve që ka filluar para fushatës zgjedhore, ende të pa përfunduar!

Qëllimet kryesore - siguria dhe kthimi

Vasilija Stanić, OSBE

Në mesin e atyre që garuan në zgjedhjet e fundit për Kuvendin e Kosovës ishin edhe dy subjekte politike nga komuniteti serb. Por, pasi që një numër shumë i vogël i votuesve serbë vendosi të votojë në këto zgjedhje, numri i ulësve që u takojnë këtyre subjekte është kufizuar në dhjetë ulëset e rezervuara. Ulëset janë ndarë ndërmjet këtyre subjekteve në mënyrë proporcionale me numrin e votave të fituara, që don të thotë se Lista Serbe për Kosovë dhe Metohi do të ketë tetë ulëse derisa Iniciativa Qytetare e Serbisë do t'i ketë dy ulëse.

Pjesëmarrja e ulët ka shtruar një pyetje te komuniteti serb, si dhe në mesin e liderëve të tyre, e ajo është: A kanë këta anëtarë të Kuvendit të Kosovës nga subjektet politike të serbëve legjitimitet ta përfaqësojnë popullin serb? Oliver Ivanovic, përfaqësues i Listës Serbe për Kosovë dhe Metohi beson se legjitimiteti nuk është në pyetje pasi që buron nga rregullat e vëna para zgjedhjeve që kanë qenë të barabarta për të gjithë. Ai mendon se Lista mund të ketë problem me kredibilitet, që është, siç e kanë dëshmuar zgjedhjet, i ulët; kështu që në këtë situatë më së miri është që të rrinë anash, thotë ai. Sidoqoftë, ai le hapësirë për ndryshim të këtij vendimi dhe shpjegon rrethanat nën të cilat kjo mund të ndodhë:

“Me një numër aq të vogël të votave është e pamundur që ne të ndërmarrim ndonjë hap serioz përderisa kredibiliteti ynë nuk përmirësohet, që don të thotë se nëse besimi i njerëzve rritet në ne, bazuar në atë se çka do të bënte bashkësia ndërkombëtare duke reaguuar në iniciativat tona; gjithashtu është e rëndësishme që Qeveria e Serbisë të kuptojë se ne jemi partnerët e saj në lidhje me çështjen që ata duan të arrijnë këtu,” thotë Ivanovic dhe vazhdon:

“Ne nuk do t'i përdorim mandatet tona në Kuvend duke pritur zhvillimet e mëtejshme, duke pritur të shohim se a do ta bëjë z. Jessen-Petersen rregulloren për decentralizim dhe se a do t'i plotësojë kjo rregullore nevojat themelore të komunitetit serb, me fjalë të tjera, a do t'i plotësojnë të drejtat dhe obligimet që u ipen komunave për kërkesat minimale të serbëve. Në anën tjetër, ne do të donim të shihnim çfarë do të ishte politika e përgjithshme e institucioneve të reja të përkohshme, pasi që çdo ndërrim në nivel të lartë shkakton ndërrim e politikës, posaçërisht në fushat ku demokracia nuk është e zhvilluar, si në Kosovë.”

Sidoqoftë, pasi këto kushte të plotësohen, anëtarët e Kuvendit të Listës Serbe për Kosovë dhe Metohi mendojnë t'i pranojnë mandatet e tyre the t'i kontribuojnë punës së Kuvendit të Kosovës:

“Funksioni ynë duhet të jetë monitorimi

i Kuvendit dhe i Institucioneve të Përkohshme të Kosovës dhe nxjerrja në pah e parregullsive, sa herë që ato t'i vërejmë. Ne gjithashtu duhet të jemi një lloj pengese për gabime, që do të thotë se çdo herë që na bëhet ndonjë padrejtësi nga ana e institucioneve, kjo duhet të ketë ndikim në raportet e bashkësisë ndërkombëtare me këto institucione”- thotë Ivanovic. “Pas 17 marsit u bënë ndryshime të caktuara të pikëpamjeve dhe mendoj se tash e tutje ne do të gëzojmë vëmendje më të madhe, kështu që çdo padrejtësi apo shkelje e Kornizës Kushtetuese apo procedurës operuese duhet të ketë pasoja, pasi që monitorimi pa pasoja nuk do të ketë kuptim. E dini, nëse PSSP do ta kishte shkarkuar Kryetarin e Kuvendit apo ndonjë ministër, apo kryetarin e komunës, shumë të këqija do të mund të parandaloheshin.”

Pasi të hyjnë në Kuvend, anëtarët e Listës Serbe të Kosovës dhe Metohisë do të punojnë në plotësimin e synimeve programore të subjektit politik.

“Sa i përket qëllimeve programore, ne do të jemi në kontakt me Institucionet e Përkohshme por edhe me UNMIK-un në mënyrë që të punojmë së bashku në përmirësimin e sigurisë dhe në ndihmesën e kthimit të personave të zhvendosur. Këto edhe ishin prioritetet tona deri më tash. Një çështje e re në dialogun e brendshëm, pikësepari ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve, pasi që problemi u shfaq së pari ndërmjet këtyre komuniteteve dhe prej aty duhet të fillojë të zgjidhet. Sidoqoftë, ne do të mundohemi të jemi konstruktiv duke u nisur nga momenti që do të bëhemi pjesë e institucioneve,” përfundon Ivanovic.

Subjekti i dytë politik që duhet t'a përfaqësojë komunitetin serb në Kuvendin e ri është Iniciativa Qytetare e Serbisë, përfaqësuesi i të cilit, Slavisha Petković, beson se një kualitet i ri duhet të silltet në punën e Kuvendit.

“Se kualiteti i ri duhet të jetë ndarje e qartë ndërmjet partive qeverisëse që kanë shumicën e anëtarëve dhe opozitës, roli i së cilës është të kritikojë punën e qeverisë. Në të njëjtën kohë, ndarja nuk duhet të bëhet në baza etnike në kuptimin që vetëm shqip-



Oliver Ivanović, Shef i Listës Serbe për Kosovë e Metohi
Foto: Magda Hejzyk/OSBE

tarët janë në pushtet dhe gjithë të tjerët janë opozitë. Partitë që e përbënin parlamentin e mëparshëm i kishin përfaqësuesit e tyre në qeveri dhe kjo shkaktoi që të mos kishte krikika gjatë punës trevjeçare, të gjithë heshtnin.”

Çështjet që anëtarët e Inicitivës Qytetare të Serbisë do t'i ngrisin me pjesëmarrjen e tyre në Kuvend janë: siguria dhe kthimi, kryesisht përkojnë me qëllimet e subjektit tjetër serb si dhe me standardet e vëna para se bisedimet për statusin final të Kosovës të fillojnë. Slavisha Petković beson se plotësimi i këtyre dy çështjeve është parakusht për çdo diskutim tjetër, duke përfshirë edhe diskutimin mbi decentralizim.

“Është shumë e rëndësishme që shqiptarët si shumicë në Kuvend të kuptojnë se ata nuk kanë të drejtë ekskluzive mbi Kosovën dhe Metohinë. Ata madje duhet të kontribuojnë, shumë më tepër se të tjerët, në siguri dhe mundësim të kthimit të serbëve. Nëse shqiptarët dhe bashkësia ndërkombëtare nuk kanë vullnet, nuk do të ndihmonte asgjë edhe sikur t'i kishim edhe 52 ulëse në Kuvend. Sigurisht që Iniciativa Qytetare e Serbisë me dy anëtarë në Parlament nuk mund të ndryshojë shumë, por së paku dëshiron t'i fillojë të gjitha këto procese,” thotë Slavisha Petković.

Intervistë me z. Adnan Merovci - Kryeshef Ekzekutiv i SKQZ-së

Ne kemi dhënë maksimumin

“Votuesi gjatë zgjedhjeve të 23 Tetorit 2004, për herë të parë pas konfliktit në Kosovë nuk ka takuar asnjë personel ndërkombëtar të angazhuar zyrtarisht në vendëvotime ditën e zgjedhjeve, që do thotë se i tërë personeli menaxhues i zgjedhjeve në teren ka qenë vendor”, thotë Adnan Merovci, Kryeshef i SKQZ-së.

Hasan Sopa, OSBE

Zgjedhjet e fundit për Kuvendin e Kosovës u vlerësuan të sukseshme nga të gjitha institucionet, si ato vendore dhe ndërkombëtare. Padyshim se meritë për mbarëvajtjen e zgjedhjeve ka edhe Sekretariati i Komisionit Qendror Zgjedhor (SKQZ-ja). Një organ vendor dhe bazuar në dokumentet legale të tij, SKQZ-ja ka qenë përgjegjëse për implementimin e rregullave të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) për zgjedhje, që kryesisht kishin të bënin me aktivitetet zgjedhore në teren.

“SKQZ-ja dhe unë personalisht kemi qenë të angazhuar që zgjedhjet t’i plotsojnë kriteret dhe atributet e parapara në bazë të Kornizës Ligjore”, thotë Adnan Merovci. Sipas tij zgjedhjet kanë qenë fer, transparente, të lira, demokratike dhe konform standardeve ndërkombëtare dhe gjithëpërfshirëse.

“Gjithëpërfshirja ka qenë brenga dhe preokupimi im i veçant dhe me gjithëpërfshirje është nënkuptuar pjesëmarrja e të gjitha bashkësive etnike në procesin e zgjedhjeve e në veçanti e serbëve”, shton z. Merovci. “Unë së bashku me zëvendësin tim z. Bogoljub Staletoviq kemi bërë çmos që gjithëpërfshirjen ta bëjmë realitet. Besoj se kemi arritur që në aspektin operativ-teknik ta realizojmë atë edhe pse nuk jemi të kënaqur me pjesëmarrjen e serbëve në zgjedhje”.

Bashkëpunimi me departamentin e zgjedhjeve të OSBE-së

Në pyetjen tonë se cili ka qenë bashkëpunimi i SKQZ-së me OSBE-në, z. Merovci thotë OSBE-ja, ka qenë autor i themelimit të SKQZ-së. “Në fillim dhe në vazhdimësi ne kemi qenë të trajnuar nga OSBE-ja dhe më vonë kemi arritur të faktorizohemi profesionalisht dhe për çdo punë dhe aktivitet kemi vepruar dhe vendosur bashkarisht”, shprehet ai.

Sipas tij, asnjë operacion i ndërmarrë nga departamenti i zgjedhjeve i OSBE-së dhe SKQZ-së nuk ka kaluar pa konsultime paraprake. “Mendoj se bashkëpunimi ka qenë profesional dhe mund të shërbejë si shembull për një bashkëpunim të mirë, por megjithatë për këtë duhet të merret edhe mendimi i homologut tim, drejtorit të departamentit të zgjedhjeve të OSBE-së, z. Lars Lagergren me të cilin shpesh kemi patur mosmarrëveshje në shijet e kravatave”, thotë z. Merovci.

Sfidat dhe përvoja e nxjerrur nga këto zgjedhje

Zgjedhjet e kaluara sipas z. Merovci kanë qenë një përvojë e madhe. Në vazhdim ai

përkujton një shprehje popullore se ‘çdo shkollë duhet paguar’. “Disa gjëra na kanë kushtuar edhe ne, por besoj se kanë shërbyer që mos të përsëriten në të ardhmen. Tani unë jam duke përpiluar një raport të detajuar dhe analitik, ku do të paraqes të gjitha lëshimet, gabimet dhe ngeçjet e SKQZ-së. Bashkëpunorët e mi veq i kanë dorëzuar këto raporte dhe ne do t’i identifikojmë shkaqet e disa lëshimeve dhe do të përpiqemi tu qasemi në mënyrë preventive në të ardhmën”, siguron z. Merovci

Kontributi i SKQZ-së në mbarëvajtjen e zgjedhjeve


“Nëse mund të thuhet se zgjedhjet kanë qenë të suksesshme atëherë meritat nuk i takojnë vetëm SKQZ-së. Në rend të parë meritat i takojnë vetë votuesve dhe vetëdijes së tyre për vlerësimin e institucionit të votës”, shprehet z. Merovci. Sipas tij, votuesit kosovar në mënyrën më të civilizuar ushtruan të drejtën e tyre për të votuar. Ai gjithashtu lavdëron fushatën parazgjedhore dhe e vlerëson si shumë korrekte dhe për këtë meritat u jep subjekteve politike pjesëmarrëse në zgjedhje.

Z. Merovci vlerëson lartë edhe kontributin e institucioneve të tjera, si vëzhguesit e Këshillit të Europës të udhëhequr nga z. Andrej Tehov, që si pas tij kanë dhënë një kontribut të pamohueshëm në mbarëvajtjen e zgjedhjeve. Gjithashtu, Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, nën udhëheqjen e znj. Jeni Sittton ka meritat e veta, sikurse edhe Komisioneri i Përkohshëm për Media, z. Bob Jilett. “Departamenti i zgjedhjeve i OSBE-së, në veçanti zyrtar rajonale nuk u kursyen asnjëherë dhe meritojnë lavdata për gatishmërinë e tyre për t’i ndihmuar SKQZ-së si dhe Komisionet Komunale Zgjedhore (KKZ) në të gjitha çështjet, thotë ai.

Z. Merovci me modesti shton se ndoshta në fund edhe SKQZ-së mund t’i atribuohet ndonjë meritë, por sipas tij kjo u takon të tjerëve të japin vlerësime për punën e SKQZ-së.

Përvoja e sjellur nga zgjedhjet presidenciale në Amerikë

“Unë isha në SHBA, me një ftesë të Fondacionit Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore IFES-Washington, një vizitë që kishte në program zgjedhjet presidenciale, dhe një seminar për financat e fushatës dhe reformat zgjedhore. Me 2 nëntor ditën e zgjedhjeve, ne vizituam disa vendvotime dhe përcollëm procesin zgjedhor në shtetin e Virjiniisë.



Adnan Merovci, Kryeshef Ekzekutiv i SKQZ-së
Foto: Hasan Sopa/OSBE

Mund të them se ishte një vizitë e vlefshme për mua dhe mora shumë nga përvoja e zgjedhjeve në SHBA, thotë z. Merovci.

Sipas tij në SHBA egzistojnë 50 KQZ dhe një Komision në nivel federal, i cili kryesisht mirret me çështjet e financave në procesin e zgjedhjeve. KQZ-të janë shumë të decentralizuara dhe shton se nivelet lokale kanë përgjegjësi të mëdha.

Gjatë vizitës së tij në SHBA z. Merovci pati vizita edhe në Departament të Shtetit dhe USAID.

Vendorët mund t’i organizojnë dhe menaxhojnë zgjedhjet e ardhshme në Kosovë

“Unë personalisht jam i bindur se as tani as në të ardhmen nuk duhet të brengosemi sa i përket menaxhimit të zgjedhjeve nga vendorët”, siguron z. Merovci. “Dua të kuptohem drejt se motoja e së ardhmes janë integritet në strukturat ndërkombëtare në të gjitha aspektet. Këtu edhe qëndron përgjigja e kësaj pyetjeje, që kjo nuk do të thotë se ne nuk mund t’i organizojmë zgjedhjet vet”.

Në fund ai shton se Misioni i OSBE-së është shumë aktiv, sidomos në çështjet që kanë të bëjnë me zgjedhjet dhe në vazhdimsi punon në ngritjen e kuadrove vendorëve. “Ky është përcaktim i tyre. KQZ-ja ende kryesohet nga Shefi i Misionit të OSBE-së, sikurse edhe KZAP-ja. Një ditë këto përgjegjësi do të jenë të vendorëve por edhe atëherë ne do të kemi nevojë për OSBE-në”, përfundon z. Merovci.

Të drejtat e njeriut gjatë rrjedhës së ngjarjeve të marsit

Ngjarjet e marsit kanë shkaktuar shqetësime serioze për të ardhmen e sigurisë së minoriteteve, duke vështirësuar mundësinë për të jetuar, udhëtuar dhe punuar në Kosovë dhe duke zvogëluar besimin në KFOR-in, Policinë e UNMIK-ut dhe Shërbimin Policor të Kosovës për të bërë patrullime në mënyrë efektive dhe krijimit të një mjedisi të sigurtë.

Antoanela Pavlova, OSBE

Më 10 qershor të vitit 1999 rezoluta 1244 e këshillit të sigurimit të kombeve të bashkuara autorizoi Sekretarin e Përgjithshëm të themelojë një administratë të përkoshshme civile të udhëhequr nga Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara (UNMIK). Një nga qëllimet kryesore e themelimit të UNMIK-ut ishte ngritja e të drejtave të njeriut në Kosovë. Edhe pas pesë viteve të ekzistimit të UNMIK-ut, shtrohet pyetja: cilat janë çështjet kryesore të drejtave të njeriut sot në Kosovë?

Më 17 mars 2004, ka filluar një protestë në Mitrovicë pas mbytnes së tre fëmijëve shqiptar të cilët gjoja janë ndjekur nga qentë dhe kanë kërcyer në lumin Ibër ku dhe janë mbytur. Protesta shpejt kaloi në një fushatë të dhunës etnike, e cila zgjati tri ditë, duke lënë prapa 19 të vdekur, 954 të lënduar dhe 4100 persona të zhvendosur, 550 shtëpi dhe 27 kisha dhe manastire ortodokse të djegura dhe përveç kësaj 182 shtëpi dhe dy kisha/manastire të dëmtuara. Shumë nga këta persona ende nuk janë në gjendje të kthehen në shtëpitë e tyre për shkak të çështjes së sigurisë, shkatërrimit të shtëpive, dhe/ose uzurpimit të paligjshëm të pronës së tyre.

Ngjarjet e marsit kanë shkaktuar shqetësime serioze për të ardhmen e sigurisë së minoriteteve, duke vështirësuar mundësinë për të jetuar, udhëtuar dhe punuar në Kosovë dhe duke zvogëluar besimin në KFOR-in, Policinë e UNMIK-ut dhe Shërbimin Policor të Kosovës për të bërë patrullime në mënyrë efektive dhe krijimit të një mjedisi të sigurtë.

Kufizimi i lirisë së lëvizjes ishte një problem për pjesëtarët e minoritetit që të gëzojnë të drejtat themelore që nga fundi i konfliktit në vitin 1999, por ngjarjet e marsit kanë kthyr mbrapa shumë nga përparimet e bëra dhe ka zmadhuar problemin ekzistues. Për shembull, mundësia për të siguruar transportimin e nxënësve për personat e zhvendosur dhe nxënësit tjerë nga minoritetet është penguar ose për shkak të mungesës së transportimit të sigurtë të objekteve ekzistuese shëndetësore ose sepse objekti është djegur apo është dëmtuar shumë. Së fundi, liria e kufizuar e lëvizjes ka keqësuar mundësinë e pjesëtarëve të komuniteteve të minoritetit që të kenë qasje në gjykata.



"Shumë nga të zhvendosurit ende kanë vështirësi për t'u kthyer në shtëpitë e tyre në mungesë të sigurisë" Foto: OSBE

Çështja që ka të bëjë me përdorimin e një gjuhe në sektorin publik vazhdon të bëhet një pengesë e dukshme për mundësinë e qasjes efektive të minoriteteve në shërbimet e nevojshme.

Uzurpimi i paligjshëm i pronës së banueshme dhe të pabanueshme ka qenë plotësisht i pranuar si problem i vazhdueshëm dhe i gjërë në tërë Kosovën. Gjatë dhe pas ngjarjeve të marsit, disa prona të shkatërruara pjesërisht apo të braktisura me forcë janë uzurpuar rishtas ose riuzurpuar në mënyrë të paligjshme, përderisa shumë prona tjera kanë mbetur të dëmtuara për uzurpim të paligjshme kur uzurpatorët kanë ikur.

Burgjet e stërbushura dhe objektet për paraburgim në Kosovë kanë qenë problem edhe para ngjarjeve të marsit (me persona të praburgosur më shumë se sa që kanë burgjet kapacitet). Sistemi i menaxhimit ndëshkimor është përballur dhe vazhdonë të përballet me probleme në akomodimin e një numri të madh të paraburgosurëve dhe të burgosurëve.

Ekzistimi i strukturave paralele në Kosovë është ndër çështjet më brengosëse dhe ka ndërlikime të ndryshme në fushën e të drejtave të njeriut. Strukturat paralele janë

definuar si organe që kanë qenë ose ende vepronë në Kosovë pas qershorit të vitit 1999 dhe të cilat nuk kanë mandat sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB-së. Në shumicën e rasteve, këto institucione vepronë sipas autoriteteve *de facto* të qeverisë serbe dhe nga Serbia pranojnë juridikacionin dhe e përshtatin për Kosovën.

Për shembull, të gjithë fëmijët e Kosovës nuk shkollohen në mënyrë të njëjtë sepse përdoren dy sisteme me planprograme të ndryshme. Kjo përbënë shkellen e të drejtave të tyre për shkollim dhe pengon perspektivën për shkollim në të ardhmen. Personat që vozisin me patent shofer të lëshuara nga autoritetet serbe janë arrestuar dhe dënuar për posedim të dokumentit të falsifikuar, çka shkelë të drejtën e tyre për liri dhe liri të lëvizjes.

Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse (IPVQ) por edhe UNMIK-u kanë përgjegjësi në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut. Nevoja për të drejtuar problemet e identifikuar më mirë më shpejt se sa vonë mbetet çështje kryesore për të parandaluar përsëritjen e dhunës për një kohë më të gjatë. Rruga përpara duhet të zhvillohet në partneritet në mes të akterëve vendor dhe ndërkombëtar.

Zgjedhjet: Një sfidë e vërtetë për RTK

Arben Hajredinaj, OSBE



Radio Televizioni publik i Kosovës (RTK), u sprovua edhe me një fushatë zgjedhore në tetor të këtij viti. Një ndër detyrat më të rëndësishme për këtë medium ka qenë të dëshmohej me punën e vetë karshi opinionit kosovar dhe atij ndërkombëtar në mbulimin e një aktiviteti që konsiderohet të jetë ndër më të ndërlikuarit në punën e përditshme. Për më tepër, RTK-ja pati rastin të dëshmohej edhe për respektimin e rregullit të hartuar nga Komisioni Qëndror Zgjedhor (KQZ).

Natyrisht se rolin më të madh në formimin dhe edukimin të opinionit e kanë mediat dhe

ato mbajnë përgjegjësi në ofrimin e kohës së barabartë për të gjitha entitetet politike për analizimin dhe shpalimin e programeve të tyre gjatë fushatës zgjedhore.

Sylejman Shaqiri, redaktor i lartë në RTK nënvizon se “roli i mediave në Kosovë në periudhën parazgjedhore është shumë i rëndësishëm, veçanërisht roli i mediave elektronike për shkak të mundësisë së mbulimit të shumë segmenteve në komunitet.”

“Përgaditja e mediave për mbulimin e fushatës parazgjedhore në mënyrë profesionale pati filluar tre apo katër muaj para hapjes zyrtare të fushatës,” shpjegon z. Shaq-

iri. Duke emituar programe informative, gazetarët dhe redaktorët ishin në kontakt direkt dhe konstant me udhëheqës dhe zyrtarë politik, të cilët mbanin edhe poste të larta në institucionet e Kosovës.

“Sfida kryesore për RTK-në ka qenë respektimi i rregullave të raportimit për aktivitetet zgjedhore”, thotë z. Shaqiri. Sipas tij, disa segmente që kërkonin përbushjen e dispozitave të këtij rregulli e kanë ‘zbehur’ përmbajtjen programore të RTK-së gjatë fushatës zgjedhore.

Mirëpo, RTK-ja kishte trajnuar dhe pajisur stafin e vetë me mjete të duhura teknike për ta mbuluar fushatën zgjedhore në mënyrë profesionale.

Z. Shaqiri shprehet gjithashtu se pjesa më e madhe e raporteve gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore mund të jenë dukur monotone meqë pjesa dërmuese e gazetarëve dhe redaktorëve ende u përmbahen normave të vjetra të raportimit. “Ata hezitojnë të provohen me qasje të reja në raportimin e aktiviteteve zgjedhore, ashtu si edhe shumica e subjekteve politike që nuk sjellin përmbajtje të reja në aktivitetet e tyre zgjedhore”, thotë ai.

“Në pjesën dërmuese të mediave lokale mungonte fare interesim që ta përcjellin fushatën zgjedhore. Shumica prej tyre nuk u ofruan as subjekteve politike hapësirë në valët e tyre transmetuese, e madje as të fitojnë nga reklamimi i paguar politik”, shprehet z. Shaqiri. “Ky është një qëndrim i pavarur i çdo mediumi por raportimi i çështjeve politike për mediat gjithmonë paraqet sprovën

Dhuna në familje shqetësim i madh

25 Nëntori është shpallur ‘Dita Ndërkombëtare Kundër Dhunës ndaj Femrave’ në mbarë botën. Në shumë vende, fushatat për eliminimin e dhunës së bazuar në gjini janë zgjatur deri në ‘Ditën Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut’ më 10 dhjetor. Ditët ndërmjet këtyre dy datave të rëndësishme janë bërë të njohura si ‘16 Ditë të Aktivizmit Kundër Dhunës.’

Magda Hejzyk, OSBE

Njerëzit në Kosovë tanimë e kanë të njohur konceptin e abuzimit të të drejtave të njeriut; 16 ditë të aktivizmit kanë për qëllim të tërheqin vëmendjen për shkelje të veçanta të të drejtave të njeriut në Kosovë.

Dhuna në familje ka një shtrirje të gjërë. Gjatë dy viteve të fundit policia ka marrë mbi 2,200 ankesa, derisa OJQ-të lokale vlerësojnë se numri aktual i shtëpive të prekura nga dhuna në familje është shumë më i madh.

Format e Dunës Familjare

Ka disa forma të shprehjes së dhunës ndaj femrave – dhunë fizike, torturë psikike, dhunim, trafikim, pozitë të pabarabartë sociale ose ekonomike dhe mungesë e mundësive të barabarta – çdo formë është problem në vete këtu në Kosovë. Hulumtimi i bërë nga Fondi i Zvillimit për Gra të Kombeve të Bashkuara (UNIFEM) ka zbuluar se gratë në Kosovë pësojnë nga dhuna nga partneri apo

anëtar i familjes: “Rrahjet dhe dhunimet nga njerëzit e njohur, duke i përfshirë bashkëshortët, vazhdojnë të ndodhin.”

Misioni i OSBE-së në Kosovë ka përkrahur aktivitetet për parandalimin e dhunës në familje, trafikimin dhe prostitucionin e detyrueshëm të grave dhe vajzave, si dhe traditat kulturore që kërcënojnë shëndetin dhe zhvillimin e grave.

vijon në fq. 12

Këtë vit, fushatat anembanë Kosovës promovuan linjat për ndihmë të Departamentit të Drejtësisë, që funksionuan nga Mbrojtësit Kosovarë të Viktimave. Fushata e OSBE-së, u fokusua në gra dhe i inkurajoi ato t'i drejtohen Mbrojtësve të Viktimave nëse i ekspozohen çfarëdo lloj dhune. Tema kryesore e fushatës ishte ekzistimi e mekanizmave mbrojtës dhe nevoja e kërkimit të ndihmës dhe lajmërimit të dhunën në familje.

Fushata transmetonte një moto të thjeshtë: "Dhuna në familje mund të ndalet! – Prano mbrojtje, telefono mbrojtësin e viktimave." Ajo arriti shikueshmëri të madhe duke i përdorur mediat e mbrendshme dhe të jashtme, si dhe me anë të një mbulimi pozitiv në shtyp, në radio e televizion si dhe reklama.

Kampanja gjithashtu promovoi shembuj të tregimeve të sukseshme përmes tregimeve të gjalla në radio si dhe organizimit të debatëve në radio e televizion. Kjo u arrit në partneritet të plotë me disa media duke u ofruar atyre statusin e 'sponsorëve medial' të cilat u reklamuan me anë të panove dhe pllakatave.

Urdhëri mbrojtës

Radio Prizreni emitoi një program me Elita Reshtanin, udhëheqësen e Strehimores për Viktima të Dhunës në Familje dhe Ismet Berishën, Koordinatorin e Njësitit Rajonal për Dhunë në Familje, të Shkollës Policore në Prizren.

Z. Berisha, i shpjegoi dëgjuesve për rolin kryesor të hulumtuesve të Dhunës në Familje. "Në pajtim me Rregulloren e UNMIK 2003/12, hulumtuesit e dhunës në familje informojnë për të drejtat e tyre dhe mekanizmat mbrojtës, të cilat janë nxjerrur nga gjyqi, me iniciativë të policisë, Qendrës për Punë Sociale, ose nga avokati i angazhuar nga vet viktimat për ta zgjidhur rastin."

"Në secilin stacion policorë brenda Prizrenit janë nga dy hulumtues të specializuar për hulumtimin e dhunës familjare", shtoi Z. Berisha duke i inkurajuar njerëzit që t'i besojnë policisë dhe t'i lajmërojnë rastet e dhunës familjare.

Elita Reshtani tha se dyert e strehimores së tyre janë të hapura për të gjithë ata të cilët kanë nevojë për ndihmë. "Viktimave të dhunës familjare, të cilët nuk kanë ku të shkojnë, u ipet një qëndrim i përkohshëm, prej tre muajsh në Strehimore."

Mënyra më e rëndomtë e dhunës familjare sipas saj është ajo psikologjike. "Kjo nuk i përjashton edhe format tjera të dhunës si ato fizike, seksuale, ekonomike të cilat i shtyejnë femrat të bëhen amvise injoruese të cilat mund vetëm të përgatisin ushqim dhe t'i kryejnë punët e shtëpisë. Kjo është arsyeja pse femrat janë të izoluar nga shoqëria," shpjegoi znj. Reshtani.

TV Dukagjini transmetoi një program të drejtpërdrejt me dy mysafirë në studio, Ganimete Loxha, mbrojtëse e viktimave për regionin e Pejës dhe Violeta Demhasaj, koordinatore regionale e policisë për dhunën në familje. Ato diskutuan për masat mbrojtëse dhe paraqitën institucionet përgjegjëse të cilat merren me çështje gjinore.

Sipas Demhasaj situata ekonomike është arsyeja kryesore për dhunën familjare. "në shoqërinë tonë, mentaliteti dhe tradita janë gjithashtu faktorë të dhunës familjare, përderisa pasojat gjithashtu barten edhe te fëmijët të cilët gjithashtu mund të bëhen agresiv dhe të dhunshëm."

Mbrojta varet vetëm nga një telefonatë

OSBE-ja gjithashtu e ka përkrahur një OJQ Boshnjake, 'Barazia' nga Prizreni, dhe projektin e tyre për vetëdijësim mbi dhunën në familje. Projekti përbante një anketë mbi dhunën familjare në Komunitetin e Boshnjakëve të Kosovës dhe gjithashtu kishte një trajnim edukativ mbi shoqërimin dhe dhunën familjare për studentët nga tri shkollat e mesme Boshnjake.

Anketa tregoi se prej 277 intervistuarve vetëm 50 prej tyre kishin njohuri për Rregulloren mbi Mbrojtjen kundër Dhunës në Familje. Në anën tjetër, prej 57 personave të cilët kanë qenë viktimat të dhunës familjare, vetëm 7 prej tyre kishin njohuri për këtë ligj.

"Numri i krimeve të raportuara rallë përputhen me numrin e rasteve aktuale të dhunës

familjare, sepse shumë viktimat ende ngurrojnë të lajmërojnë rastet dhe hapur të bisedojnë për to", tha Emilija Redzepi, udhëheqëse e OJQ-së 'Barazia'.

Ndryshimi i vetive të njerëzve drejt viktimave të dhunës familjare nuk është një përpjekje afat shkurtër. Viktimat, shkaktarët dhe njerëzit përreth tyre duhet ta kuptojnë se dhuna është e ndaluar me ligj.

Qëllimi i parë, edhe pse për një afat të shkurtër, është inkurajimi i viktimave që t'i shfrytëzojnë mekanizmat mbrojtës të cilët i kanë në disponim – mbrojtja varet vetëm nga një telefonatë.

Raport për fushatën kundër dhunës në familje

Me 10 dhjetor, Misioni i OSBE-së në Kosovë përfundoi një fushatë vetëdijësimi, me qëllim të nxitjes së viktimave të dhunës në familje që të kërkojnë ndihmë. Porosia e fushatës - Dhuna në familje mund të ndalet – u përhap në tërë Kosovën nëpërmjet panove, pllakatave dhe kartvizitave, por gjithashtu edhe nëpërmjet radios dhe televizionit.

Fushata u përqendrua në numrin e linjës ndihmëse [044 418 669] dhe ofroi informacion shtesë të nevojshëm për këtë fushë.

Rezultatet e hershme të kësaj fushate gjashtëmbëdhjetë-ditore flasin për 190 telefonata të pranuar nga Njësia për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave pranë Departamentit të Drejtësisë.

Përderisa shumica e telefonatave ishin më tepër të natyrës së përgjithshme, 25 nga ato e identifikuan vetëvehten si viktimat të dhunës në familje. Gjithashtu policia shënoi një rritje të vogël të rasteve të lajmëruara.

Ngjashëm, strehimoret kanë pranuar viktimat që kërkuar strehim, siç ishte rasti i Prizrenit që pranoi katër raste.

Misioni i OSBE-së do të vazhdojë ta luftojë dhunën në familje edhe në të ardhmen.

